



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prudato Received/Delivery	08.08.2022	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKP/M/CW	4593/2022		1/3



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.570/2022

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave** në përbërje nga: Jeton Koca-Kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.570/2022 të datës 27.06.2022 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ me adresë: \_\_\_\_\_ kundër organit të punësimit Universitetit "Haxhi Zeka" në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 08.08.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet **jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.570/2022 të datës 27.06.2022, të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_

**A r s y e t i m**

Ankuesi, \_\_\_\_\_ me datë 23.06.2022, përmes postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila ankesë është pranuar me datë 27.06.2022 dhe regjistruar me numër protokollit 3724, me shenjen A.nr.570/2022. Ankese në ankesën e parashtruar pretendon se vlerësimi i kandidateve në konkursin e shpallur për pozitën e punës *Zyrtar Ekzekutiv i Këshillit Drejtues* nga Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë është bërë në kundërshtim me dispozitat e aplikuara të ligjit material dhe përmes konstatimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit:3724/2022 të datës 27.06.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për punësim të ankuesit e datës 23.05.2022; Diplomën e ankuesit e datës 23.09.2019 me numër:834; Vërtetimin e lëshuar nga Noteri për shkresën

me shenjë: LRP-nr.Rendor:4794/2021; Çertifikatë e datës 19.09.2019; Vërtetimin e lëshuar nga Noteri për shkresën me shenjë: LRP-nr.rendor:7070/2022; Çertifikatën e lëshuar me datë 08.09.2019; Vërtetimin e lëshuar nga Noteri për shkresën me shenjë: LRP-nr.rendor:7072/2022; Çertifikatën e datës 31.05.2017; Vërtetimin e lëshuar nga Noteri për shkresën me shenjë: LRP-nr.rendor:7069/2022; Kontratën e punës praktike së ankuesit e datës 29.10.2019 lëshuar nga Universiteti "Haxhi Zeka"; Kontratën e punës për kohë të caktuar e datës 17.05.2021; Vërtetimin e lëshuar nga Universiteti "Haxhi Zeka" i datës 17.06.2020; Vërtetimin e lëshuar nga Universiteti "Haxhi Zeka" i datës 18.05.2022; Vërtetimin e datës 19.03.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 21.01.2022; Konkursin e datës 19.04.2022; Njoftimin e datës 08.06.2022; Vendimin e datës 14.06.2022 me numër prit:1373.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës **nuk është kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.570/2022 të datës 27.06.2022, e parashtruar nga ankuesi **sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të prova të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Universiteti "Haxhi Zeka" me datë 19.04.2022 ka shpallur konkursin për pozitën e punës "Zyrtar Ekzekutiv i Këshillit Drejtues", në të cilën pozitë ka aplikuar edhe ankuesi, ndërsa sipas Vendimit me numër 1369 të datës 14.06.2022 të Komisionit të Rekrutimit rezulton se ankuesi nuk është kandidati i pranuar në këtë procedurë të rekrutimit.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave lidhur me kompetencën lëndore ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 2 ku përcaktohet se 3. **Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë:** 4. **Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se zyrtaret publik të nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë në Kosovë, respektivisht në Universitet Publike, kanë statusin e nëpunësit të Shërbimit Publik.**

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civilë si dhe duke marr parasysh konstatimin se ankuesi ka aplikuar për pozitë të punës në kuadër të Shërbimit Publikë, Kolegji i Këshillit konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.570/2022 të datës 27.06.2022 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji i Këshillit bazuar në dispozitat e nenit 24 dhe 74 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konstaton se zyrtaret publikë me status të nëpunësit të Shërbimit Publik ashtu sikurse edhe



kandidatet për pranim në pozitë me status të Shërbimit Publikë kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.570/2022

**Flakron GASHI**

  
Procmajtës

**Jeton KOCA**

  
Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit "Haxhi Zeka";
- Udhëheqësit të Personelit në Universitetin "Haxhi Zeka";
- Arkivit të KPMSHCK- së.

